

KREU 1

ZOTI SI MISTER

Si të panjohur dhe megjithatë shumë të njohur.

2 Korinthianët 6:9

Zoti nuk mund të kapet me mendje. Nëse do të mund të perceptohej, nuk do të ishte Zot.

Evagri i Pondit

Një ditë disa prej vëllezërve erdhën për të parë at Andonin dhe midis tyre ishte dhe at Josifi. Duke dashur t'i provojë, plaku përmendi një tekst nga Shkrimet, dhe duke filluar nga më i riu i pyeste se për çfarë bëhej fjalë atje. Secili e shpjegoi aq mirë sa mundej. Por secilit plaku i thoshte, "Nuk është kjo përgjigjja e duhur". Së fundi pyeti edhe at Josifin: "Po ti ç'mendon?" Ai u përgjigj: "Nuk e di". Atëherë at Andoni tha: "Me të vërtetë at Josifi e gjeti udhën, se tha: Nuk e di".

Fjalë të urta nga etërit e shkretëtirës²

Si një mik që flet me mikun e tij, flet njeriu me Zotin, dhe duke u afruar me besim qëndron para Fytyrës së Njërit, që banon i paafrueshëm brenda dritës.

Shën Simeoni, Teologu i Ri

Tjetërsia dhe afërsia e të Përjetshmit

Çfarë dhe kush është Zoti?

Udhëtari në Udhën shpirtërore, sa më tutje përparon, aq më tepër fiton vetëdije të dy fakteve të ndryshme të *tjetërsisë* dhe të *afërsisë* së të Përjetshmit. Në radhë të parë, kupton gjithmonë e më shumë se Zoti është mister. Zoti është "i përsosuri Tjetër", i padukshëm, i paperceptueshëm, krejtësisht transhendent, tej të gjitha fjalëve, tej çdo arsyetimi. "Sigurisht foshnja e sapolindur, shkruan

² Rrëfime e thënie nga murgjit e hershëm, kryesisht të Egjiptit (shek. iv dhe v).

katoliku George Tyrrell, di kaq shumë për botën dhe rrugët e saj, aq sa më i mençuri nga ne mund të dijë për udhët e Zotit, rruga e të cilit shtrihet në qiell dhe në tokë, në kohë dhe në përjetësi. Një i krishterë i traditës ortodokse do të binte dakord plotësisht me këtë. Ashtu si etërit grekë theksonin: "Një Zot që është i perceptueshëm nuk është Zot", domethënë një Zot që pretendojmë t'a perceptojmë me gjithë kapacitetin e mendjes sonë, s'është asgjë më tepër sesa një idhull, i formuar sipas imazhit tonë. Një "Zot" i tillë pa dyshim nuk është Zoti i vërtetë dhe i gjallë i Biblës dhe i Kishës. Njeriu është bërë sipas imazhit të Zotit, por e kundërta nuk është e vërtetë.

Dhe megjithatë, në radhë të dytë, do të thoshja se ky Zot i misterit është në të njëjtën kohë jashtëzakonisht afër nesh, duke i mbushur të gjitha sendet, duke qenë kudo rreth nesh. Dhe është i pranishëm jo thjesht si një atmosferë a fuqi pa emër, por me një mënyrë personale. Zoti që është përfundimisht tej perceptimit tonë, na zbulon veten e tij si *person*; na thërret secilin me emrin e vet dhe ne i përgjigjemi. Midis nesh dhe Zotit të mbinatyrshëm ka një lidhje *dashurie*, e njëjtë me atë që ekziston midis nesh dhe të tjerëve, të cilët i duam shumë. I njohim njerëzit e tjerë nëpërmjet dashurisë sonë për ta dhe nëpërmjet dashurisë së tyre ndaj nesh. Kështu është edhe me Zotin.

Me fjalët e shën Nikolla Kavasila, "Zoti, Mbreti ynë, është

më i dashur se çdo mik,
më i drejtë se çdo drejtues,
më i dhembshur se çdo at,
më shumë një pjesë nga ne se sa gjymtyrët tona,
më i domosdoshëm tek ne se sa vetë zemra jonë."

Këto pra, janë dy "polet" e përvojës së njeriut për të Hyjshmin. Zoti është edhe më larg nesh, edhe më afër nesh, nga çdo gjë tjetër. Dhe çuditërisht shohim se kjo lidhje e ndërsjelltë nuk prishet; përkundrazi, sa më tepër na tërheq njëri "pol", aq më gjallërisht e ndiejmë tjetrin në të njëjtën kohë. Duke përparuar në Udhë secili sheh se Zoti bëhet gjithmonë më i afërt dhe gjithmonë më i largët, shumë i njohur dhe shumë i panjohur. Shumë i njohur tek fëmija më i vogël dhe i pakuptueshëm tek teologu më mendjemprehtë. Zoti banon në "dritë të paafrueshme", ndërsa njeriu ndodhet brenda pranisë së tij me mirëbesim të ëmbël dhe e thërret si mik. Zoti është edhe pikëmbërritje edhe pikënisje. Është Zoti që na mirëpret në fund të udhëtimit, por është edhe bashkudhëtari që ecën krahas nesh në çdo hap mbi Udhë. Siç e shpreh Shën Nikolla Kavasila, "Ai është bujtina ku prehem për një natë dhe pikëmbërritja finale e shtegtit tonë".

Mister dhe megjithatë person: le të shohim këto dy aspekte me radhë.

Zoti si mister

Nëse nuk fillojmë me ndjenjë nderimi dhe mahnitjeje - me atë që shpesh e quajmë ndjenjë e *numinous*³ - pak do të përparojmë në Udhë. Kur Samuel Palmer vizitoi për herë të parë William Blake, plaku e pyeti se si i afrohej ai veprës së pikturës. "Me frikë dhe tmerr", - u përgjegj Palmer. "Atëherë do të kesh mbarësi", tha Blake .

Etërit grekë e përgjasojnë takimin e njeriut me Zotin me përvojën e dikujt që ecën mbi male nëpër mjegull: bën një hap përpara dhe befasisht shikon se ndodhet mbi buzën e një greminë, pa truall të fortë nën këmbët e tij, por vetëm një humbëtitë e pafund. Ose, gjetkë, përdorin shembullin e një njeriu që qëndron natën në një dhomë të errët: hap kanatat e një dritareje dhe tek shikon jashtë, ndriçimi befasues i një vetëtime e bën të tërhiqet pas i tmerruar dhe për një moment i verbuar. E tillë është mbresa kur dikush ndeshet ballë për ballë me misterin e gjallë të Zotit: na jep marramendje; të gjithë hapat e njohur zhduken, dhe duket sikur për ne nuk ka asgjë për t'u kapur, sytë tanë të brendshëm janë verbuar, vlerësimet tona të përditshme lëkunden.

Gjithashtu etërit konsiderojnë si simbol të Udhës shpirtërore, dy figurat e Dhjatës së Vjetër, Abrahamin dhe Moisiun. Abrahami, kur jetonte ende në shtëpinë e stërgjyshërve të tij, në Ur të Kaldejve, dëgjoji nga Zoti t'i thotë: "Dil prej vendit tënd dhe prej vëllazërisë sate, dhe prej shtëpisë së atit tënd, në drejtim të një vendi që do të të dëftoj" (Gjeneza 12:1). Duke pranuar ftesën hyjnore, ai ikën nga mjedisi i njohur dhe rrezikon tek e panjohura, pa asnjë ide të qartë për destinacionin e tij final. Thjesht ka marrë urdhërin, "dil...", dhe i bindet me besim. Moisiu përjeton tre vegime të njëpasnjëshme nga Zoti: fillimisht sheh Zotin në një vegim drite në Kaçuben e Ndezur (Eksodi 3:2); pastaj Zoti i zbulohet brenda një drite të përzier me errësirë, në "shtyllë reje dhe zjarri", që shoqëron izraelitët brenda shkretëtirës (Eksodi 13:21); dhe së fundi takon Zotin në një "jo-vegim", kur flet me të brenda "mjegullës së dendur", në majë të Malit Sina (Eksodi 20:21).

Abrahami udhëton nga shtëpia dashamirëse drejt një vendi të panjohur; Moisiu ecën nga drita në errësirë. Dhe kështu provohet se ndodh me këdo që ndjek Udhën shpirtërore. Ikën nga e njohura drejt të panjohurës, ecën nga drita në errësirë. Nuk përparojmë thjesht nga errësira e padijes në dritën e njohurisë,

³ Fjalët *drojte* dhe *frikë* në këtë term janë shumë afër.

por marshojmë nga drita e pjesshme në një njohje më të madhe që është kaq shumë më e thellë saqë mund të përshkruhet si "terri i së panjohurës". Ashtu si Sokrati fillojmë të kuptojmë se sa pak gjëra dimë. Shikojmë se detyra e krishtërit nuk është të japë përgjigje të lehta në çdo pyetje, por të na bëjë njohës të një misterit në një mënyrë që vjen duke u rritur. Zoti nuk është kaq objekti i dijes sonë, sesa shkaku i mahnitjes sonë. Duke iu referuar Psalmi 8:2: "O Zot, Zoti ynë, sa i mrekullueshëm është emri yt në mbarë dheun", shën Grigori i Nisës konstaton: "Emri i Zotit nuk është i njohur; është i çuditshëm".

Duke ditur se Zoti është pa krahasim më i madh se çfarëdo që mund të themi a të mendojmë për të, e shohim të nevojshme të përdorim jo vetëm referime direkte, por gjithashtu dhe përfytyrime e imazhe. Teologjia jonë është *simbolike* në një shtrirje të madhe. Por ama simbolet në vetvete nuk mjaftojnë për të shprehur mbinatyrshtësinë dhe "tjetërsinë" e Zotit. Që të kthehemi drejt *mysterium tremendum* (misterit të frikshëm) e shohim të nevojshme të përdorim formulime jo vetëm mohuese por edhe pohuese, duke thënë më tepër çfarë *nuk* është Zoti, sesa çfarë është. Pa këtë përdorim të mënyrës mohuese, që quhet përafrim apofatik, të folurit tonë për Zotin bëhet seriozisht çorientues. Të gjitha sa pohojmë në lidhje me Zotin sado të sakta që të jenë nuk mjaftojnë për të shprehur të vërtetën e gjallë. Nëse themi se është i mirë, i drejtë, menjëherë duhet të shtojmë se mirësia apo drejtësia e tij nuk mund të maten me kritere njerëzore. Nëse themi se ekziston, këtë duhet t'a cilësojmë menjëherë duke shtuar se nuk është objekt ekzistent ndër të tjerë, sepse në rastin e tij fjala "ekzistoj" ka një domethënie të vetme. Kështu mënyra pohuese baraspeshohet nga ajo mohuese. Siç e shpreh kardinali Newman, vazhdimisht: "herë themi po dhe herë jo, për një përfundim pozitiv". Duke pasë bërë një pohim në lidhje me Zotin, duhet të themi: formulimi nuk është i pasaktë, por as ai, as asnjë formë tjetër fjalësh mund të nxjehë plotërisht e Zotit transhendent.

Kështu Udha shpirtërore provohet se është një shteg pendimi në kuptimin më rrënjësor. *Metánoia*,⁴ fjala greke për pendimin, literalisht do të thotë "ndryshim i mendjes". Duke iu përafuar Zotit duhet të ndryshojmë mendjen, duke e zhveshur vetveten nga të gjitha mënyrat e rëndomta të të menduarit. Duhet të shndërrojmë jo vetëm vullnetin por edhe mendjen. Duhet të kthejmë në drejtim të kundërt perspektivën tonë të brendshme, të kthejmë përmbys llogjikën tonë.

⁴ Termat grekë autori i transliteron sipas mënyrës perëndimore, gjë që nuk shpreh fonetikën e greqishtes bizantine a të re, siç përdoren sot në kishën greqishtfolëse dhe siç janë transliteruar në përkthimet kishtare të Nolit (për përdorim muzikor). Këtu ruhet mënyra e autorit, por duke dhënë ndonjëherë edhe theksin ose transliterimin shqip.

Dhe megjithatë "mjegulla e dendur" ku futemi bashkë me Moisiun bëhet një errësirë e ndritshme apo verbuese. Mënyra apofatike e padijes na sjell jo në zbrazëti por në plotësi. Mohimet tona janë në të vërtetë mbipohime. Shkatërrimtar në pamjen e jashtme, përafrimi apofatik është pohues në rezultatet përfundimtare: na ndihmon të afrohemi tej çdo formulimi pohues a mohues, tej çdo gjuhe dhe çdo mendimi, drejt një përvoje të menjëhershme të Zotit të gjallë.

Kjo shprehet vërtet me vetë fjalën "mister". Në kuptimin e mirëfilltë fetar të termit, "mister" do të thotë jo vetëm fshehje por edhe zbulim. Emri grek *mysterion/mistírion* lidhet me foljen *myein*, që do të thotë "mbyll sytë a gojën". Tek disa nga fetë mistike pagane, kandidatit për t'u futur në to, së pari i mbyllnin sytë dhe e drejtonin përmes një labirinthi korridorësh; pastaj befasisht i zbulonin sytë dhe shikonte, të ekspozuara përçark tij, emblemat e kultit. Si rrjedhojë në kontekstin e krishterë ne nuk kuptojmë me një "mister", thjesht atë që është e pakuptueshme dhe misterioze, një enigmë a një problem të pazgjidhur. Përkundazi një mister është diçka e cila *zbulohet* që t'a kuptojmë, por që kurrë nuk e kuptojmë *imtësisht*, sepse na çon në thellësinë ose në errësirën e Zotit. Sytë janë mbyllur - por janë gjithashtu hapur.

Kështu, duke folur për Zotin si mister, vijmë në "polin" e dytë. Zoti është i fshehur nga ne, por gjithashtu na zbulohet: zbulohet si person dhe si dashuri.

Besimi në Zot si person

Në Besore nuk themi "Besoj se ekziston një Perëndi" por themi "Besoj në një Perëndi". Midis togfjalëshit "besimit *se*" dhe "besimit *në*", ka një dallim kritik. Është e mundur të besoj *se* dikush a diçka ekziston, dhe megjithatë kjo bindje nuk ka efekt praktik në jetën time. Mund të hap katalogun telefonik të Wigan-it dhe të lexoj imtësisht emrat e regjistruar në faqet e tij; dhe teksa lexoj jam i përgatitur të besoj se disa (ose madje shumica) prej këtyre njerëzve me të vërtetë ekzistojnë. Por nuk njoh asnjë prej tyre personalisht, asnjëherë nuk e kam vizituar Wigan-in dhe kështu bindja ime se ekzistojnë nuk ka për mua asnjë rëndësi. Përkundrazi kur një miku të shumëdashur i themi, "*të besoj*", bëj diçka shumë më tepër sesa të shpreh bindjen se ky person ekziston. "Të besoj" do të thotë: kthehem tek ty, mbështetem mbi ty, kam besim të plotë tek ty. Dhe kjo është ajo që i themi Zotit në Besore.

Pra besimi në Zot nuk ngjet fare me llojin e sigurisë llogjike që arrijmë në gjeometrinë euklidiane. Zoti nuk është konkluzioni i një procesi arsyetimesh, apo zgjidhja e një problemi matematik. Të besosh tek Zoti nuk është të pranosh mundësinë e ekzistencës së tij sepse na është "provuar" me një argument teorik, por është të kemi besim të plotë tek Njëri që njohim dhe duam. Besimi nuk është supozimi se diçka ndoshta është e vërtetë, por të qenurit të sigurt se dikush është atje.

Meqenëse besimi nuk është siguri llogjike por marrëdhënie personale, dhe përderisa kjo lidhje personale është madje shumë e mangët tek secili nga ne dhe është e nevojshme të përsoset vazhdimisht, është e mundur të bashkekzistojë besimi me dyshimin. Këta të dy nuk përjashtojnë njëri-tjetrin. Ndoshta ka disa që me hirin e Zotit ruajnë gjatë gjithë jetës së tyre besimin si i një fëmije të vogël, që u jep aftësinë për të pranuar pa dyshim të gjitha çfarë kanë mësuar. Por për shumicën e atyre që jetojnë sot në Perëndim, një qëndrim i tillë thjesht nuk është i mundur. Duhet të familjarizohemi me klithmën "Besoj o Zot; ndihmoje mosbesimin tim!" (Marku 9:24). Për shumë e shumë nga ne kjo do të mbetet lutja jonë e pareshtur gjer në dyert e vdekjes. Dhe megjithatë dyshimi nuk tregon mungesë besimi. Ndoshta ndodh e kundërta - besimi ynë është i gjallë dhe vjen duke u shtuar. Sepse besimi nuk sjell me vete lumturi por rrezikim, jo izolim nga e panjohura por marshim të guximshëm për t'a takuar atë. Këtu një i krishterë ortodoks pa vështirësi mund të përjetojë fjalët e peshkopit I. A. T. Robinson: "Akti i besimit është një dialog i përhershëm me dyshimin". Ashtu si me të drejtë thotë Thomas Merton: "Besimi është një burim dyshimi dhe ndeshjeje përpara se të bëhet burim sigurie dhe paqeje."

Pra besimi tregon një lidhje personale me Zotin; një lidhje që megjithëse është gjithë mangësi dhe ngurrim, nuk është më pak e rëndësishme. Njohja me Zotin nuk duhet parë si teori apo si një parim abstrakt, por si udhë për të takuar një person. Të njohësh një person është diçka shumë më tepër sesa të njohësh ngjarjet që lidhen me atë person. Që të njohësh një person në thelb do të thotë t'a duash atë. Nuk mund të ketë njohje të vërtetë të personave të tjerë pa dashuri të ndërsjellë. Nuk kemi asnjë njohje të vërtetë për ata që urrejmë. Këtu pra, janë dy mënyrat më pak çorientuese për të folur për Zotin, i cili tejkapërcen arsyetimin tonë: ai është *personal* dhe vetë ai është *dashuri*. Këto janë në thelb dy mënyrat për të konceptuar të njëjtën gjë. Udhë për t'u futur në misterin e Zotit realizohet nëpërmjet dashurisë personale. Siç thotë *Mugëtira e padijes*, "Mund të bëhet objekt dashurie, por jo objekt mendimi. Misterin mund t'a kapim dhe t'a mbajmë nëpërmjet dashurisë, por kurrë me mendimet."

Si një tregues të zbehtë të kësaj dashurie personale që mbizotëron midis besimtarit dhe Subjektit të besimit të tij, le të marrim tre shembuj a ilustrime në fjalë. I pari është nga një tregim i shekullit të dytë, nga martirizimi i shën Polikarpit. Ushtarët romakë sapo kanë mbërritur për të arrestuar peshkopin e thyer në moshë Polikarp, dhe t'a çojnë atje ku ai e di se e pret vdekja:

Kur dëgjoji se mbërritën, zbriti dhe u foli. Të gjithë mbetën të shtangur nga moshja e thyer dhe qetësia e tij dhe habiteshin se përse autoritetet kërkonin me kaq ngulm të arrestonin një plak të moçëm. Menjëherë dha urdhër që t'u sillnin për të ngrënë e për të pirë sa të donin, megjithëse ishte vonë dhe u kërkoi që t'a lejojnë të lutet për një orë pa e shqetësuar. Mbasirane dakord u ngrit në këmbë dhe u lut. Dhe ishte kaq i mbushur me hirin e Zotit, sa që zgjati për dy orë lutja e tij. Tek po e dëgjonin e kuptoi se ata mbërritën, zbriti dhe foli me ta. Të gjithë mbetën të shtangur e shihnin me habi të madhe dhe shumë prej tyre ndjenin keqardhje që erdhën për të arrestuar një njeri të shenjtë si ai. Ai përkujtoi me emra të gjithë sa kishte takuar gjatë jetës së tij, të mëdhenj e të vegjël, të famshëm e të panjohur, dhe Kishën e Përgjithshme në gjithë botën.

Kaq e flakëruar është dashuria e tij për Zotin, dhe me besimin se kjo dashuri te Zoti është po kaq e thellë për gjithë gjininë njerëzore, sa që në këtë moment kritik shën Polikarpi mendon vetëm të tjerët dhe jo rrezikun e tij personal. Kur guvernatori romak i thotë se do t'i shpëtojë jetën duke mohuar Krishtin, ai përgjigjet: "Tetëdhjetë e tetë vjet i shërbeva dhe nuk më dëmtoi gjëkundi. Atëherë si mund t'a blasfemoj Mbretin tim, i cili më shpëtoi?"

Shembullin e dytë e jep shën Simeoni, Teologu i Ri në shekullin X, i cili përshkruan se si Krishti iu zbulua në një vegim drite:

Ndriçove mbi mua me shkëlqim verbues dhe, kështu u duk, m'u shfaqe brenda tërësisë sate teksa me gjithë qënien time të vështroja i shtangur. Dhe kur thashë, "O Zot, cili je?", atëherë pranove të flasësh për herë të parë me mua plangprishësin. Me çfarë butësie më fole ndërsa qëndroja i mahnitur dhe plot tmerr! Për pak çaste u mendova thellë në veten time dhe thashë: "Ç'do të thotë kjo lavdi dhe ky shkëlqim marramendës? Si u zgjodha unë që të kem një bekim kaq të madh?" "Jam Zoti, u përgjigje, që u bëra njeri për hirin tënd dhe meqenëse më ke kërkuar me gjithë zemër, që tani e tutje do të jesh vëllai im, bashkëtrashëgimtari im dhe miku im."

Shembulli i tretë është një lutje e shkruar nga një peshkop rus i shekullit XVII, shën Dhimitri i Rostovit:

*Eja, Drita ime dhe ndriço terrin tim.
Eja, Jeta ime dhe gjallëromë nga vdekja.*

*Eja, Mjeku im dhe shëroi plagët e mia.
Eja, Flakë e dashurisë hyjnore dhe digji
gjembat e mëkateve të mia,
duke ndriçuar zemrën time me flakërinë e dashurisë sate.
Eja, Mbreti im, ulu mbi fronin e zemrës sime dhe atje mbretëro.
Sepse vetëm ti je Mbreti im dhe Zoti im.*

Tre "Treguesit"

Pra, Zoti është Njëri që duam, miku ynë personal. Nuk ka nevojë të provojmë ekzistencën e një miku personal. Zoti, thotë Olivier Clement, "nuk është një dëshmi e jashtme, por ftesa e fshehtë brenda nesh". Nëse besojmë në Zot, kjo është nga që e njohim drejtpërdrejt nga përvoja jonë dhe jo nga argumentet llogjike. Megjithatë këtu është e nevojshme të bëjmë një dallim midis "përvojës" dhe "përvojave". Përvoja direkte mund të ekzistojë pa qenë e nevojshme të shoqërohet me përvoja të veçanta. Në të vërtetë të shumtë janë ata që arriten të besojnë në Zot nga ndonjë zë a vegim, si ai që pati shën Pavli gjatë rrugës për në Damask (Veprat 9:1-9). Por ka shumë të tjerë që nuk kanë kaluar kurrë nga përvoja të veçanta të këtij lloji, por mund të pohojnë se, gjatë gjithë jetës së tyre, kanë përjetuar një përvojë të plotë të Zotit të gjallë, një bindje që qëndron në një nivel më të fortë se sa të gjitha dyshimet e tyre. Madje dhe nëse ata nuk mund të japin një dëshmi për një vend a moment të caktuar, siç munda shën Augustini, Paskali ose Wesley, mund të pohojmë pa ngurrar: *E njoh Zotin personalisht.*

E tillë është, si rrjedhojë, "dëshmia" themelore për ekzistencën e Zotit: një ftesë për përvojë të drejtpërdrejtë (por jo doemos për përvojë). Por ndërsa nuk mund të ekzistojnë prova llogjike për realitetin hyjnor, ka disa tregues. Në botën rreth nesh ashtu si edhe brenda nesh, ka fakte që kërkojnë një shpjegim, por që ngelen të pashpjegueshme nëse nuk mbështetemi në besimin tek një Zot personal. Tre "tregues" të tillë duhet të përmenden në veçanti:

Së pari, është *bota rreth nesh*. Çfarë shikojmë? Rrëmujë e madhe dhe shkretim i dukshëm, dëshpërim shumë tragjik dhe dhimbje e padobishme në dukje. Kjo është e gjitha? Sigurisht që jo. Nëse ekziston një "problem i së keqes", ekziston gjithashtu dhe një "problem i së mirës". Kudo që të shikojmë, nuk shohim vetëm çrregullim por edhe bukuri. Në flokun e borës, në gjethë a në insekte, zbulojmë modele të strukturuar me kaq delikatesë dhe balancë, saqë asgjë e prodhuar nga mjeshtëria njerëzore nuk mund t'a arrijë. Nuk bëhet fjalë për të shpjeguar këto gjëra në mënyrë sentimentale, por nuk mund të mos i përfillim.

Si dhe përse u shfaqën këto modele? Në qoftë se merr një pako me kartolina të saposjellura nga fabrika, me të katër cepat të vendosur me radhë dhe rregull, dhe filloj t'i përziej, atëherë sa i përziej aq shpejt zhduket dhe modeli fillestar dhe zëvendësohet me një radhë të pakuptimtë. Por në rastin e gjithësisë ka ndodhur e kundërta. Brenda një kaosi fillestar kanë dalë modele të shumta dhe domethënie që shtohen gjithmonë e më tepër, dhe në mes gjithë këtyre modeleve ajo që është më shumëformëshe dhe më domethënëse është vetë njeriu. Përse procesi që ndodh në paketën me kartolina do të duhej të përmbysset pikërisht në nivelin e Universit? Çfarë e kush është përgjegjës për këtë renditje kozmike dhe për këtë model? Pyetje të tilla nuk janë absurde. Është vetë llogjika që më shtyn për të kërkuar një shpjegim kudo ku dalloj rregull dhe domethënie.

"Misri ishte orient dhe grurë i pavdekshëm që kurrë nuk duhej të korrej, as ishte mbjellur ndonjëherë. Kujtova se ishte atje përjetësisht. Pluhuri dhe grurët e rrugës ishin të shumëçmuar si ar... Pemët e gjelbëra, kur i pashë për herë të parë përmes një porte, më ngazëllyen dhe më magjepsën; Ëmbëlsia dhe bukuria e tyre e pazakontë e bënë zemrën time të gufojë, dhe për pak të marrëzohet nga ekstaza, ngaqë ekzistojnë kaq gjëra të çuditshme..." Perceptimi femënor i Thomas Traherne për bukurinë e botës mund të paralelizohet me tekste të shumta nga burime ortodokse. Këtu, p.sh., janë fjalët e princit Vladimir Monomakh të Kievit:

Shih qiellin, diellin dhe hënën dhe yjet, errësirën dhe dritën, dhe tokën që është shtrirë mbi ujëra, si janë renditur, o Zot, me kujdesin tënd! Shih kafshët e ndryshme dhe zogjtë dhe peshqit si stolisen me përkujdesjen tënde të dashur, o Zot! Dhe për këtë mrekulli, gjithashtu e admirojmë: Si e krijove njeriun nga pluhuri dhe sa ndryshojnë në pamje fytyrat njerëzore; dhe nëse mundeshim të grumbullojmë të gjithë njerëzit nga gjithë bota, nuk do të ekzistonte as edhe një me të njëjtën pamje, por secili me urtësinë e Zotit ka pamjen e tij. Le të mahnitemi gjithashtu se si shpezët e qiellit ikin nga parajsja e tyre; nuk rrinë në një vend, por shtegtojnë së bashku, të fuqishëm dhe të pafuqishëm, drejt të gjitha viseve me urdhërin e Zotit, në të gjitha pyjet dhe fushat.

Kjo prani e domethënies bashkë me pështjellimin brenda botës, e koherencës dhe e bukurisë bashkë me kotësinë tonë, jep "treguesin" e parë për tek Zoti. Një tregues të dytë e gjejmë brenda nesh. Përse tej dëshirës sime për kënaqësi dhe pakënaqësisë sime për dhembjen, të kem brenda një ndjenjë detyre dhe detyrimi moral, një ndijim të së mirës dhe të keqes, një vetëdije? Dhe kjo vetëdije nuk më thotë thjesht t'u bindem rregullave që më mësuam të tjerët; ajo është personale. Përse përveç kësaj, kështu siç jam i vendosur brenda në kohë

dhe në hapësirë, gjej brenda meje atë që shën Nikolla Kavasila quan "etje të pakufishme" ose etje për çfarë është e përjetshme? Cili jam? Çfarë jam?

Përgjigjja e këtyre pyetjeve nuk është aspak e thjeshtë. Caqet e njeriut janë jashtëzakonisht të gjera; secili nga ne di shumë pak për veten e tij të vërtetë dhe të thellë. Me aftësitë perceptuese të jashtme dhe të brendshme, me kujtesën dhe me fuqinë e ndërgjegjes, zgjatemi mbi hapësirën kozmike, shtrihemi prapa dhe përpara brenda kohës, dhe arrijmë përtej hapësirës dhe kohës, në përjetësi. "Brenda zemrës ka thellësi të pafund", thonë *Ligjërimet e shën Makarit*. "Nuk është veçse një enë e vogël dhe megjithatë atje ekzistojnë dragoj dhe luanë dhe qenie helmuese dhe gjithë thesarët e së keqes; atje ka shtigje të ashpra e të thepisura dhe hone të hapura. Atje gjithashtu është Zoti, janë ëngjëjt, ka jetë dhe mbretëri, ka dritë, janë apostujt, qytetet qiellore dhe thesarët e hirit: të gjitha janë atje."

Me këtë mënyrë kemi, secili në zemrën e tij, një "tregues" të dytë. Çfarë do të thotë ndërgjegjja ime? Cili është shpjegimi që kam për ndjenjën e së pafundmes? Brenda meje ka diçka që vazhdimisht, më bën të shikoj tej vetes sime. Brenda meje sjell një burim mrekullie, një burim për një vetëkapërcim.

Një "tregues" i tretë duhet të gjendet në *marrëdhëniet e mia me njerëzit e tjerë*. Për secilin nga ne (ndoshta vetëm një a dy herë gjatë gjithë jetës sonë) kanë ekzistuar momente të një zbulimi të befasishtëm, ku na u shfaq ekzistenca më e thellë dhe e vërteta e një njeriu tjetër, dhe fituam përvojë nga jeta e tij e brendshme sikur të ishte e jona. Dhe ky takim me personalitetin e vërtetë të një tjetri është edhe një herë një kontakt me atë që është e mbinatyrshe dhe jashtë kohe, me diçka më të fortë se vdekja. Që t'i themi tjetrit me gjithë zemër, "Të dua", është sikur t'i themi: "Nuk do të vdesësh kurrë". Në çaste të tilla të një pjesëmarrjeje personale, dimë, jo nëpërmjet argumentesh por me bindje të menjëhershme, se tej vdekjes ka jetë. Prandaj në marrëdhëniet tona me të tjerët, ashtu si dhe me përvojën tonë me vetveten, kemi çaste transhendence që dëshmojnë se diçka ekziston më tutje. Si do të mund të jemi besnikë të atyre momenteve dhe t'i përjetojmë?

Këta tre "tregues" (në botën rreth nesh, në botën brenda nesh dhe në marrëdhëniet tona ndërpersonale) mund të ndihmojnë së bashku, si një mënyrë për afrimi, duke na sjellë në pragun e besimit tek Zoti. Asnjë nga këta "tregues" nuk përbën një provë llogjike. Por cila është zgjidhja tjetër? Mund të themi se renditja e dukshme në gjithësi është thjesht koincidençë, se ndërgjegjja është rezultat i edukimit shoqëror, dhe se kur jeta në këtë planet përfundimisht do të zhduket, të gjitha ato që gjinia njerëzore ka jetuar si përvojë, dhe gjithë

potenciali ynë do të jetë sikur nuk ka qenë kurrë? Një përgjigje e tillë më duket jo vetëm fare e pakënaqshme dhe çnjerëzore, por dhe tmerrësisht absurde.

Është element themelor në karakterin tim si njeri të kërkoj kudo për të gjetur shpjegime kuptimplote. E bëj këtë edhe në gjërat më të vogla në jetën time; e si të mos e bëj atëherë në më të mëdhatë? Besimi tek Zoti më ndihmon të kuptoj se përse bota do të duhej të ishte siç është, jo vetëm me bukurinë por edhe me shëmtinë e saj; përse duhet të jem siç jam, jo vetëm me fisnikërinë time por edhe me ligësinë time; dhe përse duhet të dua të tjerët, duke pohuar vlerën e tyre të përjetshme. Pa besimin tek Zoti nuk mund të shoh asnjë shpjegim për të gjitha këto. Besimi tek Zoti më aftëson të konceptoj sendet, t'i shikoj si një shumë harmonike, me një mënyrë që asgjë tjetër s'mund të m'a japë. Besimi më mundëson që nga të gjitha këto të bëj njëren prej tyre.

Esencë dhe energji

Për të treguar dy "polet" që ka lidhja e Zotit me ne - i panjohur dhe megjithatë i njohur mirë, i fshehur dhe megjithatë i zbuluar - tradita ortodokse bën një dallim midis esencës, natyrës ose të qënurit më të brendshëm të Zotit, nga njëra anë, dhe energjitë e tij, veprimet apo aktet e fuqisë së tij, nga ana tjetër.

“Është jashtë të gjitha sendeve sipas esencës së tij, shkruan shën Athanasi, por është brenda të gjitha sendeve me aktet e fuqisë së tij”. “E njohim esencën nga energjia, pohon shën Vasili. Askush nuk e ka parë kurrë esencën e Zotit, por besojmë tek esenca sepse marrim përvojë të energjisë”. Me esencën e Zotit kuptohet tjetërsia e tij, me energjitë, afërsia e tij. Për arsye se Zoti është një mister tej perceptimit tonë, kurrë nuk kemi për të mësuar esencën e tij a qënien e brendshme të tij, as në këtë jetë dhe as në jetën e ardhshme. Nëse njohim esencën, kjo do të thoshte se njohim Zotin në të njëjtën mënyrë që ai njih veten; dhe këtë nuk mund ta bëjmë kurrë, përderisa ai është Krijuesi dhe ne jemi krijesa. Por, ndërsa esenca e brendshme e Zotit është përgjithmonë tej aftësisë sonë perceptuese, energjitë e tij, hiri, jeta dhe fuqia mbushin gjithë universin dhe janë për ne drejtpërdrejt të arritshme.

Esenca, si rrjedhojë shpreh transhëndencën absolute të Zotit, energjitë, afërsinë dhe kudondodhjen e tij. Kur ortodoksët flasin për energjitë hyjnore, nuk kuptojmë me këtë një burim nga Zoti, një "ndërmjetës" midis Zotit dhe njeriut, apo një send, a një "dhuratë" që jep Zoti. Përkundrazi, energjitë janë vetë Zoti brenda veprimitarisë dhe vetëzbulimit të tij. Kur një njeri njih ose merr pjesë në energjitë hyjnore, ai me të vërtetë njih ose merr pjesë tek vetë Zoti, përse është

e mundur kjo për një krijesë. Por Zoti është Zot dhe ne jemi njerëz; dhe kështu, ndërsa ai na zotëron, ne nuk mund t'a zotërojmë më të njëjtën mënyrë.

Ashtu siç do të ishte gabim nëse konsiderojmë energjitë si një "send" që na dhuron Zoti, kështu do të ishte njësoj çorientuese po të marrim energjitë si një "pjesë" e Zotit. Hyjnia është e thjeshtë dhe e pandarë dhe nuk mund të pjesëtohet. Esenca do të thotë gjithë Zoti siç është në të vërtetë; energji do të thotë gjithë Zoti siç është në veprim. Zoti në tërësinë e tij është tërësisht i pranueshëm tek çdonjëra nga energjitë e tij hyjnore. Si rrjedhojë dallimi esencë - energji është një mënyrë për të përcaktuar njëkohësisht se *i gjithë* Zoti është i paarritshëm dhe se *i gjithë* Zoti, duke shfaqur dashurinë e tij, është bërë i arritshëm tek njeriu.

Për shkak të këtij dallimi midis esencës hyjnore dhe energjive hyjnore mund të pohojmë mundësinë e një bashkimi të drejtpërdrejtë ose mistik midis njeriut dhe Zotit, atë që etërit grekë e quajnë hyjnizim të njeriut (*Theosis*), por njëkohësisht përjashtojnë çdo njëjtësim panteistik ndërmjet të dyjave; sepse njeriu merr pjesë në energjitë e Zotit, jo në esencë. Ka bashkim, por jo shkrirje apo përzjerje. Megjithëse "i bashkuar" me hyjnoren, njeriu prapëseprapë mbetet njeri; nuk humbet a zhduket, por midis tij dhe Zotit vazhdon të ekzistojë gjithmonë një lidhje person me person "Unë - Ti".

Pra, i tillë është Zoti ynë: i pakuptueshëm në esencën e tij, por i njohur në energjitë e tij; tej dhe mbi të gjitha sa mund të mendohemi dhe të shprehemi, dhe megjithatë më afër nesh sesa vetë zemra jonë. Me mënyrën apofatike dërrmojmë të gjithë idhujt apo përfytyrimet mendore që krijojmë për të, sepse e dimë se të gjitha janë të padenja karshi madhësisë së tij të pakrahasueshme. Por njëkohësisht me lutjen dhe shërbimin tonë aktiv brenda botës, zbulojmë çdo çast energjitë e tij hyjnore, praninë e tij të drejtpërdrejtë në çdo person dhe në çdo send. Ditë për ditë, çdo orë, e prekim. Jemi, siç thotë Francis Thompson, "në tokë të njohur". Të gjitha përçark nesh janë "gjëja e shumëmadhërishtme"; shkalla e Jakovit është "e vendosur midis qiellit dhe Charing Cross-it:

O botë e padukshme, të shikojmë,
O botë e paprekur, të prekim,
O botë e pakuptueshme, të njohim,
E pakapshme, të rrokim dhe të shtrëngojmë.

John Eriugena thotë se "çdo krijesë e dukshme apo e padukshme është një hyjdukje, një *theofani*, shfaqje e Zotit. "I krishterë është ai që, kudo që të hedhë

sytë, shikon kudo Zotin dhe ngazëllehët me të. Me të drejtë të krishterët e parë i kanë dhënë Krishtit këtë përcaktim: "Ngre gurin dhe do të më gjesh; prej drurin më dysh dhe do të jem atje."

* * *

Përfytyro një shkëmb të thepisur dhe të rrëpirët, me një cep të ngritur në majë. Tani përfytyro se çfarë do të ndjente një njeri, në qoftë se vinte këmbën në atë buzë gremine dhe duke vështruar poshtë drejt humnerës, nuk gjen as pikëmbështetje të qëndrueshme, as kurrgjë tjetër për t'u kapur, Kjo është, mendoj, eksperienca e shpirtit kur shkon tej lëvizjes mbi sendet lëndore, në kërkim të asaj që nuk ka përmasa dhe ekziston para gjithë shekujve. Sepse nuk ekziston asgjë nga ku mund të mbahet, as vend, as kohë, as masë, as asgjë tjetër që mendja jonë të mund ta arrijë. Dhe kështu shpirti, duke rrëshqitur në çdo pikë nga ku mund të kapet, dalldiset dhe hutohet, rikthehet edhe një herë tek ajo që është për të e bashkënatyrshme, tani i kënaqur që njeh thjesht këtë për të Lartin, se është krejt ndryshe nga natyra e sendeve që njeh shpirti.

Shën Grigori i Nisës

Mendo një njeri që natën qëndron në shtëpi me të gjitha dyert mbyllur dhe pastaj përfytyro të hapet një dritare pikërisht në çastin që shkrep befasisht. I pazoti për të duruar këtë dritë verbuese, mbrohet duke mbyllyr sytë dhe duke u tërhequr mbrapa, larg dritares. Kështu ndodh me shpirtin që është i mbyllur në mbretërinë e shqisave; nëse ndonjëherë shikon vjedhurazi përmes dritares së mendjes përmbetet nga shkëlqimi, si vetëtimja, i sigurisë se Shpirti i Shenjtë është brenda tij. Duke mos mundur të durojë shkëlqimin nga drita që u zbulua, hutohet dhe menjëherë tërhiqet tërësisht në veten e tij duke kërkuar strehë si në një shtëpi, në mes të sendeve ndijimore dhe njerëzore.

Shën Simeoni, Teologu i Ri

Cilido që përpiket të përshkruajë me fjalë Dritën e parrëfyeshme është me të vërtetë gënjështar, jo sepse urren të vërtetën, por sepse është i paaftë për t'a treguar.

Shën Grigori i Nisës

Leri ndijimet dhe punët e mendjes, dhe gjithçka shqisat dhe mendja mund të perceptojnë, dhe gjithçka nuk ekziston; dhe përmes padijes afroje qënien tënde,

përsa kjo është e mundur, me atë që është tej çdo ekzistence dhe njohurie. Me këtë mënyrë, me një shkëputje të papajtueshme, absolute dhe të pastër nga vetja dhe nga të gjitha gjërat, duke kapërcyer të gjitha dhe i liruar nga të gjitha, do të udhëhiqesh për së larti, drejt atij rrezatimi të errësirës hyjnore që është tej çdo ekzistence.

Duke u futur në errësirën që kapërcen perceptimin, do të ndodhemi në një gjendje ku jo vetëm nuk do të kemi mundësi të themi shumë gjëra, por do të jemi në heshtje dhe padije të plotë.

I zbratur nga të gjitha njohuritë, njeriu bashkohet në pikën më të lartë të vetvetes, jo me ndonjë krijesë, as me veten e tij, as me asnjë tjetër, por me Njërin që është krejtësisht i papërceptueshëm dhe duke mos ditur asgjë, njeh me një mënyrë që tejkalon perceptimin.

Shën Dhionis Areopajiti

Pamja e Zotit është e parrëfyeshme dhe e papërshkrueshme dhe nuk mund të shihet me sytë e trupit. Është i panxënshëm në lavdi, i pakuptueshëm në madhësi, i pakapshëm në epërsi, i pakrahasueshëm në fuqi, i paarritshëm në urtësi, i përsosur në dashuri, i papërshkrueshëm në bamirësi.

Ashtu si shpirti brenda njeriut nuk duket përderisa është i padukshëm, por e njohim ekzistencën e tij nga lëvizjet e trupit, kështu edhe Zoti nuk mund të shihet me sytë e njeriut, por shikohet dhe dihet nga kujdesi dhe veprat e tij.

Theofili i Antiokisë

Nuk e njohim Zotin në esencën e tij. E njohim në një farë shkalle nga madhështia e krijesës së tij dhe nga përkujdesja largpamëse për të gjitha krijesat. Sepse me këtë mënyrë si para një pasqyre, bëhemi të vetëdijshëm për mirësinë e tij të pafund, të urtësisë dhe të fuqisë së tij.

Shën Maksim Konfessori

Gjëja më e rëndësishme që ndodh midis Zotit dhe shpirtit të njeriut është të dashurojë dhe të dashurohet.

Kalistos Katafijotis

Dashuria për Zotin është ekstatike dhe na bën të dalim nga vetja jonë; nuk e lejon më të dashuruarin t'i përkasë më vetes së tij, por i përket vetëm të Dashurit.

Shën Dhionis Areopajiti

Di se i palëvizshmi zbret;
Di se i padukshmi më shfaqet;
Di se ai që është jashtë nga gjithë krijesa
Më merr brenda tij dhe më fsheh në krahët e tij,
Dhe atëherë gjendem jashtë gjithë botës.
Unë, një i brishtë, vocërrak i vobektë brenda botës,
shoh krijuesin e botës, të gjithin brenda meje vetë;
Dhe e di se nuk do të vdes, përderisa jam brenda Jetës,
Kam të gjithë Jetën që vërshon brenda meje si gurrë.
Ai është në zemrën time, është në qiell;
Edhe atje edhe këtu më shfaqet me të njëjtën lavdi.

Shën Simeoni, Teologu i Ri.